

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues, të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Hasan Sadiku dhe Veli Kryeziu, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. L., nga Gj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>1</sup> dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 2 të KPRK, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati M. M., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.42/2015, e datës 20.05.2015, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datat 30.07.2015, 06.08.2015 dhe 28.09.2015, më datën 28.09.2015, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datën 01.10.2015, e përpiloi me shkrim këtë :

## AKTGJYKIM

I akuzuari E. L., nga babai Xh. dhe nëna H., e lindur K., i lindur më ..., në fshatin H., Komuna e K., me vendbanim në Gj., rr.”...”, nr. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i shkurorëzuar, babë i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

## I.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse fillimisht në kohën e pa vërtetuar të muajit ... 2015, ka importuar nga Turqia përmes Shqipërisë për në Kosovë, substancë narkotike të llojit “...” me qëllim shitje e që edhe me datën ... .2015, rreth orës ... minuta, në magjistralen Gjilan-Kamenicë, përballë të ..., përderisa ka qenë duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “...”, me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë e ..., fillimisht i gjendet te fshehura ... gram, materie narkotike të llojit “...” e që më pastaj në një shtëpi të pa banuar në fshatin Q., i gjinden edhe ... gram, materie narkotike të llojit të njëjtë e që pesha e përgjithshme e së cilës arrin në 1589.4 gram, si dhe me rastin e bastisjes në banesën e tij në lagjen “...” në Gj., i është gjetur edhe ... peshore digjitale për matjen e substancës narkotike, si dhe janë gjetur të holla prej ... dhe materia narkotike dhe të hollat i sekuestrohen dhe i njëjti arrestohet,

- me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK.

Ndaj të akuzuarit E. L., nga Gj., duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të KPP,

## II.

## REFUZOHET AKUZA

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sepse më datën ... .2015, rreth orës ... minuta me rastin e kontrollit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse në shtëpinë e prindërve tuj, në fshatin H., është vërtetuar se i njëjti në mënyrë të paautorizuar ka siguruar dhe mbajtur në pronësi, katër paketime me materie eksplozive të llojit ... në peshë prej 1829.1 gram, e cila edhe i sekuestronet,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 2 të KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë dispozitave të lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 62, 69, 73, 74, 75, 76 dhe 83 të KPRK, si dhe në bazë të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>2</sup> të akuzuarit i shqipton :

## DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit E. L., për shkak të kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjajtje prej 2 (dy) vjetëve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1000 € (njëmijë Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Ndërprehet paraburgimi ndaj të akuzuarit E. L. dhe i njëjti është liruar më datën 28.09.2015.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit E. L. do t'ju llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 02.03.2015 deri më datën 28.09.2015, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

Konfiskohet këto sende : automjeti i udhëtarëve, i markës "...", me tabela të regjistrimit ...; substanca narkotike e llojit "...", në peshë të përgjithshme prej 1589.4 gramë; ... peshore digjitale për matjen e substancave narkotike; ..., si dhe materia eksplozive, e llojit ... , në peshë prej 1829.1 gramë.

Detyrohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## ARSYETIMI

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit E. L., nga Gj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 2 të KPRK.

Si gjatë shqyrtimit fillestar, ashtu edhe gjatë gjyqësor i akuzuari E. L., pas leximit të aktakuzës, ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK (dispozitivi I i këtij aktgjykimi), ndërsa ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 2 të KPRK (dispozitivi II i këtij aktgjykimi).

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Prokurori i shtetit, Afrim Shefkiu, gjatë fjalës përfundimtare, ka deklaruar se në mungesë të provave, ka hequr dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit E. L., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 2 të KPRK (dispozitivi II i këtij aktgjykimi), ndërsa ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, sa i përket veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK.

I akuzuari E. L. dhe mbrojtësi i tij, avokati E. L., gjatë fjalës përfundimtare i ka propozuar trupit gjykues që ndaj të akuzuarit të shqiptojë një dënim sa më të butë, ngase i akuzuari se është penduar thellë dhe ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale.

## 2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi

Siç është cekur edhe më parë, i akuzuari E. L., pas leximit të aktakuzës, ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin M. M.; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Trupi gjykues, ka konstatuar se i akuzuari E. L., gjatë shqyrtimit gjyqësor, paraprakisht ishte njoftuar për pasojat dhe benefitet ligjore që mund të rrjedhin si rezultat i pranimin të fajësisë.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i akuzuari E. L., me dashje dhe me qëllim të shitjes së narkotikëve, substancave psikotrope apo substancave analoge, e ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 273 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se “Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge” dhe për këtë formë të

kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 3 (tre) deri në 10 (dhjetë) vjet. Në anën tjetër, “...” konsiderohet substancë e cila me Ligjin për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë<sup>3</sup> (Neni 2 lidhur me Tabelën I të këtij Ligji), është shpallur narkotikë. Pas pranimin të fajësisë, trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin E. L., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 3 të KPRK, ngase veprimet e të njejtin i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtin është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njejtin, siç e ka pranuar edhe vetë, në kohën e pa vërtetuar të muajit Janar 2015, ka importuar nga Turqia përmes Shqipërisë për në Kosovë, substancë narkotike të llojit “...” me qëllim shitje e që edhe me datën ...

<sup>3</sup> Ligji Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, i datës 19.02.2008 (Neni 2 lidhur me Tabelën I të këtij Ligji).

.2015, rreth orës ... minuta, në magjistralen Gjilan-Kamenicë, përballë të ..., përderisa ka qenë duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "...", me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë e kaltër, fillimisht i gjendet te fshehura ... gram, materie narkotike të llojit "." e që më pastaj në një shtëpi të pa banuar në fshatin Q., i gjinden edhe ... gram, materie narkotike të llojit të njëjtë e që pesha e përgjithshme e së cilës arrin në 1589.4 gram, si dhe me rastin e bastisjes në banesën e tij në lagjen "... në Gj., i është gjetur edhe ... peshore digjitale për matjen e substancës narkotike, si dhe janë gjetur të holla prej ... dhe materia narkotike dhe të hollat i sekuestrohen dhe i njëjti arrestohet.

#### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73, 74 dhe 75 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës trupi gjykues e ka zbutur dënimin, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe këtë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. Kjo është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur me rrethanat tjera të shënuara më poshtë, tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale. Përveç kësaj, si rrethana tjera posaçërisht lehtësuese, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i akuzuari para trupit gjykues ka deklaruar se është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale; se i njëjti ka qenë kooperativë me zyrtarët policor; se sipas deklaratës së të akuzuarit të cilës trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është babë i dy fëmijëve; sjelljet tepër të mira të të akuzuarit gjatë seancave gjyqësore; se sipas evidencave të kësaj, i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër

penale në Kosovë<sup>4</sup> dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë më ndonjë veprë tjetër penale. Andaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që u cekën më lartë, trupi gjykues ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Për këto arsye, trupi gjykues ka vlerësuar se shqiptimi i dënimit në kuadër të minimumit dhe maksimumit të posaçëm të kësaj forme të veprës penale (dënim me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dhjetë burgim), me të vërtetë, duke i marrë për bazë të gjitha këto rrethana posaçërisht lehtësuese, do të ishte një dënim shumë i rëndë për të akuzuarin.

Kurse, në anën tjetër, trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin E. L..

#### 6. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1000 € (njëmijë Euro) ndaj të akuzuarit E. L., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të akuzuarit.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

<sup>4</sup> Shkresat e referentëve të kësaj Gjykate, të datës 28.09.2015.

## 7. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Trupi gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i akuzuari E. L., refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

## 8. Vendimi lidhur me paraburgimin

Trupi gjykues, ka vendosur që ndaj të akuzuarit E. L., të ndërprehet paraburgimi dhe i njejtë është liruar më datën 28.09.2015, ngase kanë pushuar së ekzistuar të gjitha arsyet ligjore për mbajtjen e mëtejme në paraburgim.

Edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 02.03.2015 deri më datën 28.09.2015, është vendosur që të akuzuarit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, ashtë që 1 (një) ditë paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

## 9. Dënimi plotësues dhe konfiskimi i sendeve

Duke u bazuar në nenin 273 paragrafi 5 të KPRK, trupi gjykues ka vendosur që ta konfiskojë automjetin e udhëtarëve të markës "...", me tabela të regjistrimit ..., ngase me të është bërë transportimi i substancës narkotike, siç është cekur në dispozitivin I të këtij aktgjykimi. Poashtu, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, trupi gjykues ka vendosur edhe që të konfiskohet substanca narkotike e llojit "...", në peshë të përgjithshme prej 1589.4 gramë dhe ... peshore digjitale për matjen e substancave narkotike.

Meqë në banesën e të akuzuarit E. L., është gjetur substancë narkotike dhe peshorja e lartcekur, kurse në anën tjetër, i akuzuari E. L., është i papunë dhe sipas deklaratës së tij, ka gjendje të dobët ekonomike, atëherë trupi gjykues ka ardhur në përfundim se duhet të konfiskohet edhe shuma të hollave prej ..., ngase të njejtat janë rezultat i veprës penale të kësaj natyre, siç parashihet në nenin 69 paragrafi 1 të KPRK.

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 282 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1. të KPP, pavarësisht faktit se është refuzuar akuza, ka vendosur që ta konfiskojë materien eksplozive e llojit ..., në peshë prej 1829.1 gramë, për shkak se kjo materiae është e rrezikshme dhe konfiskimi i saj është në interes të sigurisë së përgjithshme.

## 10. Vendimi për refuzimin e akuzës

Meqë prokurori i shtetit gjatë fjalës përfundimtare, në mungesë të provave, ka hequr dorë nga ndjekja penale sa i përket veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, atëherë, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, e refuzoi akuzën sa i përket kësaj vepre penale.

## 11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 50 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Krimeve të Rënda  
Më 01.10.2015

Sekretarja juridike,  
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.